

FATF & OJF-të

Rekomandimi 8

Nga 40 Rekomandimet e FATF, Rekomandimi 8 për OJF-të specifikon një kërkesë të gjerë për të rregulluar sektorin jofitimprurës në tërësi, për një transparencë dhe përgjegjshmëri më të madhe. Qarkullimet financiare tek dhe përmes OJF-ve konsiderohen sipas standarteve të FATF si një burim i mundshëm për financimin e terrorizmit. Qeverive u kërkohet të mbrojnë sektorin e OJF-ve nga abuzimi ose keqpërdorimi për qëllime të krimit financiar përmes zbatimit të një regjimi rregullator që adreson në mënyrë të përshtatshme dhe efektive rreziqet e financimit të terrorizmit në sektor.

Rekomandimi 8 u rishikua në vitin 2016, pas një lobimi të vazhdueshëm nga Koalicioni Global i OJF-ve mbi FATF, duke rezultuar në heqjen e karakterizimit afatgjatë të organizatave jo-fitimprurëse si "veçanërisht të prekshme" ndaj abuzimit terrorist. Gjuha e mëparshme çoi në mbirregullime dhe kufizime të papërshtatshme për OJF-të, duke penguar punën e tyre legjitime dhe të nevojshme në të gjithë botën.

Formulimi i ri i Rekomandimit 8 thekson qartë se jo të gjitha OJF-të janë të rrezikuara dhe i drejton vendet të përdorin një qasje të bazuar në risk për marrjen e masave kundër financimit të terrorizmit.

Qasja e Bazuar në Risk

FATF thekson zbatimin e një Qasjeje të Bazuar në Risk për rregullimin e sektorit në mënyrë që veprimtaria e tyre e ligjshme të mos ndikohet. Gjithsesi, zbatimi i standarteve në nivel kombëtar, nuk ka qenë gjithnjë i bazuar në risk apo proporcional. Qeveritë kanë zbatuar një qasje të njëjtë ndaj të gjithëve, e cila çon në pasoja të padëshiruara për sektorin, duke përfshirë vështirësitë operationale që ndikojnë në lirinë e organizimit dhe të shprehjes, dhe çështje që lidhen me aksesin financiar.

Shumë nga këto kufizime janë kodifikuar tashmë në ligjet kombëtare. Prirja është ende për të mbirregulluar sektorin jofitimprurës. Kjo qasje është jo efektive si për qeverinë në lidhje me mandatin e saj në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ashtu edhe për OJF-të në lidhje me veprimtarinë e tyre të përditshme.

40 FATF REKOMANDIMET

REKOMANDIMET
PËRKATËSE PËR
OJF-të:

1 8 13
24 25




QASJE E NJËJTË PËR TË GJITHË

Sektori i OJF-ve perceptohet i tëri si i rrezikuar nga abuzimi me FT

VS


QASJE E BAZUAR NË RISK (REKOMANDOHET)

Sektori i OJF-ve është divers dhe vetëm një pjesë e tij, që mund të paraqesë risk të lartë ndaj FT, duhet të identifikohet në mënyrë që masat të jenë efektive



Nivelet e riskut

- I lartë
- Mesatar
- I ulët



Vlerësimi i Riskut Sektorial

Identifikon riskun ndaj FT në sektorin e OJF-ve në mënyrë që masat të targetojnë vetëm OJF-të në risk



©Global NPO Coalition on FATF

Kjo fletëpalosje u përgatit në kuadër të projektit “Organizatat Jofitimprurëse në Shqipëri dhe Rekomandimi 8 i FATF”, i cili financohet nga Projekti Global i GIZ ‘Lufta kundër qarkullimit të paligjshëm të fondeve’.